

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA TAKON GUIDO DE SANCTIS, KRYETARIN E RI TË PREZENCËS SË OSBE-SË



Ministri Manja takon Kryetarin e ri të Prezencës së OSBE-së, Ambasadorin Guido De Sanctis. Manja theksoi që me Prezencën e OSBE-së në Tiranë do të vazhdojë bashkëpunimi dhe partneriteti i kahershëm për të çuar përpara punët e nisura dhe të tjera projekte të reja që janë në vijim. Ekspertiza dhe mbështetja e Prezencës së OSBE-së do të jetë një vlerë e shtuar për Strategjinë e re të Edukimit Ligjor të Publikut, si dhe në draftimin e dy strategjive të tjera të reja: "Strategjinë ndërsektoriale kundër korrupsionit, 2023-2030" dhe Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit, si një fushë tepër e gjerë dhe që kërkon ndërmarrjen e masave nga një sërë institucionesh. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E MBROJTJES SË VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024-2030



Në shtëpinë e Europës në Tiranë, në kuadër të Ditës Evropiane të Viktimave të Krimit, u diskutua mbi sfidat dhe rrugëtimin në mbrojtjen e viktimave të krimit në vendin tonë. Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së viktimave të krimit 2024-2030, synon të përafrojë legjislacionin vendas me Aquis të BE-së dhe të parashikojë masa për bashkëpunimin ndërinstytucional në kuadër të zbatimit të mekanizmave mbrojtës dhe rehabilitues të viktimave të krimit. Manja shprehu që kjo strategji nuk duhet të jetë një "strategji në letër për strategji" por një dokument i zbatueshëm për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave të krimit. Kjo strategji ka nevojë për kontributet e të gjithë profesionistëve të ligjit, organizatat e shoqërisë civile që meren me trajtimin e viktimave të krimit, studentë të drejtësisë dhe shkencave sociale që studiojnë brenda dhe jashtë vendit, por dhe ekspertë ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Drejtësisë! [LEXO PËR MË SHUMË](#)

MINISTRI MANJA TAKIM ME AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË TURQISË, Z. TAYYAR KAĞAN ATAY



Një takim miqësor mes Ministrit Manja dhe Ambasadorit të Republikës së Turqisë z. Tayyar Kağan Atay. Në këtë takim u identifikuan pikat e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, të cilat do të përkthehen në projekte konkrete me vizitën e Ministrit Manja si Ministër i Drejtësisë në Ankara. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

SHQIPËRI - MALI I ZI, MBLEDHJE E PËRBASHKËT MES DY QEVERIVE



Në Podgoricë u zhvillua mbledhja e dytë e përbashkët mes dy qeverive. Në këtë takim u finalizua marrëveshja për ndërtimin e urës mbi Bunë që do lidhë Ulqinin me Velipojën. Gjithashtu ura të tjera bashkëpunimi do të ndërtohen dhe në fushën e drejtësisë. Tre marrëveshjet dypalëshe që u dakordësuan, ishin për të filluar menjëherë nga puna, për t lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor mes autoriteteve në dy vendet tona respektive, në interesin më të lartë të qytetarëve. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

TRYEZË E RRUMBULLAKËT DISKUTIMI MBI EFEKTET E HARTËS SË RE GJYQËSORE



Këshilli Kombëtar i Helsinkit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të trupit diplomatik, realizoi eventin publik "Tryezë e Rrumbullakët Diskutimi mbi Efektet e Hartës së Re Gjyqësore". Synimi i këtij eventi ishte diskutimi me grupet e interesit për gjetjet dhe konkluzionet e reflektuara në Dokumentin e Politikave (Policy Paper), të hartuar mbi efektet e hartës së re gjyqësore në sistemin e drejtësisë, për garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve. Harta e re gjyqësore është një hap i rëndësishëm në zbatimin e reformës në drejtësi, e cila synon standardizimin e kohës mesatare të dhënies të vendimeve, shpërndarjen e drejtë të gjyqtarëve në gjykata dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë në vend. Në këtë tryezë ishte prezent dhe Zv.Ministri i Drejtësisë, z.Klajd Karameta, i cili parashtrroi aspekte të ndryshme të punës së realizuar për ri-organizimin e rrethve gjyqësore dhe të kompetencave tokësore të gjykatave në bashkëpunim me KLGJ. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

TAKIM MBI SISTEMIN E INTEGRUAR TË TË DHËNAVE TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR



Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga KLGJ, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Shërbimi I Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IM Kavajë, u zhvillua takim ndërinstytucional i radhës mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Fokusi i këtij takimi ishte diskutimi sa më konkretisht i problematikave dhe mbarëvajtjen sipas institucioneve përgjegjëse të Sistemit të Integruar, të cilat iu referuan dhe përfaqësuesit të AKSHI-t në Ministrinë e Drejtësisë. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë shprehu mbështetjen maksimale për zgjidhjen e çdo problematike dhe zhvillimin e mëtejshëm të Sistemit të Integruar, me qëllim përmirësimin e statistikave, analizave dhe kërkimeve për të miturit në konflikt me ligjin. [LEXO PËR MË SHUMË](#)